



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KABINETI

Njoftim për shtyp

Lënda: Mbi sqarimin e artikullit “Autoriteti i Konkurrencës-Hartohen ligje për kufizim të tregut”

Autoriteti i Konkurrencës duke çmuar rolin e medias në informimin e publikut, vlerëson se është i dosmosdoshëm sqarimi i artikullit “Autoriteti i Konkurrencës-Hartohen ligje për kufizim të tregut”, botuar në gazetën “Korrieri” të datës 22 Mars 2008, në respektim të ligjit në të njëjtën faqe dhe sipërfaqe si artikulli “Autoriteti i Konkurrencës-Hartohen ligje për kufizim të tregut”.

Autoriteti i Konkurrencës sqaron se në raportin vjetor të punës për vitin 2007 i është kushtuar një nënkapitull më vete “Vlerësimi Legjislativ”, që buron nga neni 69 i ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, ku janë dhënë opinionet e Autoritetit lidhur me projektaktet e paraqitura për mendim.

Por, në asnjë rast dhe në asnjë rrjesht të Raportit Vjetor, nuk gjen konstatime se “shtrembërimi i konkurrencës për biznesin e ka zanafillën nga vetë ligjet që harton qeveria” apo se “nga vlerësimet legjislative që Autoriteti i Konkurrencës iu ka bërë projektligjeve të qeverisë në 11 prej tyre preken elementët e sigurisë”?!.

Pa dashur të ndalemi në çdo paragraf të shkrimit, ju sqarojmë se Autoriteti i Konkurrencës është i shqetësuar për mënyrën e komentimit dhe trajtimit të argumentit për shkak të deformimit të konsiderueshëm që i është bërë punës së institucionit në dhënien e rekomandimeve për projekt-aktet ligjore.

Autoriteti i Konkurrencës sqaron se respektimi i detyrimit ligjor për vlerësimin nëse aktet ligjore të paraqitura për mendim sjellin kufizime, shtrembërimi apo deformime të konkurrencës në treg nuk nënkupton automatikisht që këto projekt-akte kanë “shkallë të kufizimit dhe cënimit të konkurrencës” siç shkruhet në artikull. Përkundrazi, duhet theksuar se në të gjitha rastet Autoriteti i Konkurrencës është shprehur dakort në parim me projekt-aktet e paraqitura dhe ka dhënë rekomandimet për përmirësimin e tyre.